



Raport

**Vizita studimore
në Kilkenny - Irlandë**

14-18 Shtator 2014

Luan Nushi

Instituti për Planifikim Hapësinor
Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor



- Vendi:** Kilkenny - Irlandë
- Data:** 14 – 18 Shtator 2014
- Organizatori:** Këshilli i Evropës - Projekti për Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë, i përkrahur nga Liam Scott (Haritage Council – Irlandë); këshillues Terry O’Regan (ekspert i Këshillit të Evropës), të cilët i falënderoj për organizimin shumë profesional të vizitës.
- Pjesëmarrës:** Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Komuna e Mitrovicës
Zyrtarët rajonal për trashëgimi kulturore (Peja, Mitrovica, Prizreni, Gjlani dhe Prishtina)
Këshilli i Evropës – PPKD



Fig. Pjesëmarrësit - Rendi i parë nga e majta: **Luan Nushi** (Drejtor në Institutin për Planifikim Hapësinor); **Safet Kamberi** (Nënkryetar i Komunitetit të Mitrovicës); **Merita Limani** (Këshilli i Evropës); **Terry O’Regan** (Ekspert në Këshillin e Evropës); Rendi i dytë nga e majta: **Fitim Bunjaku** (Kordinator për rajonin e lindjes – Gjlani); **Liam Scot** (Këshilli i Trashëgimisë – Irlandë); **Fatmir Beka** (Kordinator për rajonin e veriut – Mitrovicë); **Adile Zhubi** (Kordinator për rajonin e perëndimit – Pejë); **Harmonije Radoniqi** (Këshilli i Evropës); **Michele Bergdoll** (Këshilli i Evropës); **Brikene Hoxha** (Kordinator për rajonin e qendrës – Prishtinë); **Flaka Xërxa** (Kordinator për rajonin e jugut – Prizren); **Vjollca Aliu** (Drejtoreshë në Departamentin e Trashëgimisë Kulturore).

- Qëllimi kryesor:** Vizita studimore e organizuar nga Projekti për Diversitetin Kulturor në Kosovë kishte për qëllim njohjen me praktikën e Republikës së Irlandës në planifikim dhe trajtimin e duhur të trashëgimisë kulturore, njohjen me subjektet e involvuara dhe instrumentet e shfrytëzuara. Përmes takimeve dhe diskutimeve që u zhvilluan në nivele dhe institucione të ndryshme, u ofrua mundësia që përmes rasteve konkrete, të njihemi me procedurat dhe akterët kryesor në këtë problematikë.
- Konstatimi** Pas analizave dhe krahasimeve, konstatim i përbashkët ishte se, situata sa i përket trashëgimisë kulturore në Kosovë nuk është e mirë dhe se duhet të ndërmerren hapa urgjent për përmirësim. Trashëgimia kulturore nuk është monopol i askujt, është e të gjithë neve, prandaj edhe angazhimi duhet të jetë maksimal nga të gjithë.
- Vërejtje:** Raporti është rezultat i shënimeve të marra edhe nga diskutimet e rastit, të cilat në formën se si janë marrë mund të kenë ndonjë pa-korrektësi të vogël. Ndërsa fotot e prezantuara në raport, janë origjinale dhe të realizuara gjatë vizitave në terren.



Të dhënat e përgjithshme për Irlandën

Emri:	Republika e Irlandës;
Popullsia:	4.832.765 (shkalla e rritjes: 1.2%); shkalla e lindjeve: 15.18/1000; shkalla e mortalitetit të foshnjave: 3.74/1000; jetëgjatësia: 80.56 (2014);
Kryeqyteti:	Dublin, 1.21 milion banorë (2011);
Rregullimi shtetëror:	Republikë Demokratike;
Presidenti i Shtetit:	Michael D. Higgins (2011);
Kryeministri:	Enda Kenny (2011);
Përkatësia fetare:	Katolik 84.7%, Kisha e Irlandës 2.7%, Mysliman 1.1%, të tjerë 1.7%, të papërcaktuar 1,5%, pa fe 5.7% (2011);
Përkatësia Nacionale:	Irlandez 84.5%, të tjerët të bardhë 9.8%, aziatik 1.4%, të zi 1.4%, të përzier dhe të tjerët 0.9%, të papërcaktuar 1.6% (2011);
Njësia monetare:	Euro (përpara paundi irlandez);
GDP per capita:	\$41.300, me shkallë reale të rritjes 0.6%;
Sipërfaqja:	68.889 km ²
Gjuha zyrtare:	Irlandeze dhe angleze




Fig.2. Harta, flamuri dhe pozita e Republikës së Irlandës në Evropë.

Pak histori

Të dhënat tregojnë për banimet e para të gjetura qysh para 8000 vjetëve. Ndërsa kthesë në historinë e Irlandës është shënuar me invadimin e Vikingëve në shekullin e 9 dhe të mercenarëve Normanë në shekullin e XII-të, të cilët për shtatë shekuj me radhë ushtruan terror me rregullat dhe ligjet shumë diskriminuese për popullsinë vendore. Të gjitha kryengritjet u shtypen, u masakruan të gjithë ata që nuk i bindeshin ligjeve të mbreti anglez. Toka e punueshme i merrej katolikëve irlandez dhe i jepej protestantëve okupatorë anglez dhe skocez. Ky diskriminim ka vazhduar edhe më tej, në shekullin XVIII të gjitha ligjet nxirreshin në dëm të popullatës vendore të krishterë.

Përpjekjet për pavarësi kanë vazhduar gjatë gjithë kohës për të kulmuar më 24 Prill të vitit 1916 me kryengritjen e zhvilluar në Dublin, e cila u shtyp nga forca të mëdha angleze dhe të gjithë organizatorët u ekzekutuan. Ky brutalitet u kthye në revoltë gjithë popullore e cila në vitin 1919 u shndërrua në luftë për pavarësi që zgjati deri në vitin 1922, kur 26 krahina u shkëputën nga Mbretëria e Bashkuar për të themeluar shtetin e sotëm të Republikës së Irlandës. Aktualisht janë edhe 6 krahina tjera që sot njihen me emrin Irlanda Veriore, që ende janë pjesë e Mbretërisë së Bashkuar. Kjo është edhe arsyeja që konflikti është ende prezent, kërkesat dhe presioni i nacionalistëve për bashkimin e Irlandës është i vazhdueshëm edhe pse në vitin 1998 është nënshkruar marrëveshja e paqes e cila ende është në fuqi.

Ekonomikisht Irlanda filloj të zhvillohej pas pavarësisë, përkatësisht gjatë viteve të pesëdhjeta. Më 1973 Republika e Irlandës bëhet anëtare e plotë e Bashkimit Evropian, e cila e ndihmojë në konsolidimin e gjendjes së përgjithshme ekonomike, përmes ndihmës direkte dhe investimeve të huaja. Kulmi i zhvillimit u shënuar gjatë viteve të nëntëdhjeta, kur Irlanda e fitoj epitetin "the Celtic Tigre". Ky zhvillim u ndërpre me krizën financiare që filloj në vitin 2008 të shkaktuar nga kriza globale ekonomike. Edhe përkundër kësaj, aktualisht Irlanda mbetet ende njëri nga vendet më prosperuese. Sipas Indeksit Human të Zhvillimit (Kombet e Bashkuara) në vitin 2011 dhe 2013 Irlanda renditet në mesin e shtatë vendeve më të zhvilluara në botë.

Sot, Irlanda vazhdon të jetë vend i prosperitetit vend i traditës dhe i shanseve për të gjithë.

Fig. Kështjella e Kilkenit (shek. XII)



Disa nga prezantimet dhe diskutimet e rëndësishme gjatë vizitës

Këshilli për Trashëgimi

An Chomhairle Oidhreachta
The Heritage Council



Vizita dhe takimi i parë u zhvillua në Këshillin e Trashëgimisë të Republikës së Irlandës, në të cilin një prezantim hyrës u bë nga udhëheqësi (z. Michael Starret, Kryeshef Ekzekutiv) sipas të cilit, Këshilli është themeluar si një organ ligjor me Aktin e Trashëgimisë (1995). Këshilli ka një qasje të integruar të trashëgimisë, duke përfshirë të dy aspektet e saj kulturore dhe natyrore. Ligji i Trashëgimisë ofron një përkufizim për "trashëgiminë" sipas të cilit në të përfshihen monumentet, objektet arkeologjike, objektet të trashëgimisë, të artit duke i përfshirë edhe objektet industriale, trashëgiminë arkitektonike, florën, faunën, habitatet e kafshëve të egra, peizazhet, parqet natyrore etj.¹ Për të gjitha këto përgjegjës është Këshilli për Trashëgimi i Irlandës me seli në Killkeny, në të cilin janë të angazhuar 15 punonjës të profesioneve të ndryshme dhe një rrjet i fuqishëm i bashkëpunimit. Njëri ndër sukseset më të mëdha janë planet lokale të trashëgimisë kulturore, që në fakt paraqesin instrumentin kryesor të trajtimit dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të kësaj vlere të çmueshme. Vlera e saj është vërtetuar gjatë recesionit ekonomik që po kalon Republika e Irlandës. Turizmi kulturor dhe natyror ka qenë dhe është burimi i rigjenerimit të përgjithshëm ekonomik për vendin. Aktualisht në Irlandë duke e përfshirë edhe Kilkenin (i klasifikuar si qytet mesjetar), 80% e vizitave bëhen për shkaqe turistike. Në të gjithë vendin ekzistojë 60.000 monumente të trashëgimisë kulturore të niveleve dhe karakteristikave të ndryshme, që janë nën mbrojtje të ligjit, por, forca më e madhe mbrojtëse është komuniteti, janë qytetarët që me fanatizëm kujdesën për trashëgiminë e tyre.

Njëri prej aktiviteteve të rëndësishme të Këshillit është përkrahja financiare për organizatat e ndryshme në realizimin e projekteve lokale të trashëgimisë. Ekziston një lidhje konkrete e Këshillit me komunat përmes 28 zyrtarëve të trashëgimisë, të cilët pjesërisht financohen edhe nga komunat. Për çdo 1 euro të shpenzuar nga Këshilli për Trashëgimi, industria turistike e Irlandës i fiton 4.4 euro. E shprehur në vende pune, investimet e realizuara (6.15 milion euro gjatë periudhës 2004-2008) në planet komunale të trashëgimisë kulturore kanë ndikuar në krijimin e më tepër se 1000 vendeve me orar të plotë punës.

Edukimi është gjithashtu një fushëveprim i rëndësishëm i Këshillit, i cili përmes programeve të ndryshme lokale dhe qendrore promovon dhe ndikon në ngritjen e vetëdijes për mirëmbajtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore. Një kontribut të veçantë në këtë drejtim ofrojnë zyrtarët e trashëgimisë që janë të shpërndarë në të gjithë vendin. Përmes forumeve të trashëgimisë kulturore lokale, në të cilat janë të përfshirë të gjitha strukturat dhe nivelet e shoqërisë (mesatarisht 30 anëtarë) duke i përfshirë edhe politikanët, arrihet të artikuloohen nevojat buxhetore dhe hapat e nevojshëm për ruajtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të trashëgimisë. Një shembull i këtij bashkëpunimi është Projekti i varrezave të vjetra i cili për qëllim ka identifikimin dhe sigurimin e shënimeve të sakta për to.



Fig. Takimi në zyrën qendrore të Këshillit

¹ <http://www.heritagecouncil.ie/about-us/about-us/#sthash.Gu2E1GX7.dpuf>

Në vazhdim të takimit u organizua vizita në Katedralen St.Canices e ndërtuar në fillim të shekullit XIII. Gjendja fizike e objektit dëshmon për kujdesin dhe trajtimin që i bëhet trashëgimisë në përgjithësi. Në bazë të hulumtimeve dhe të gjeturave, zona në të cilën ndodhet katedralja daton prej shek. të VI-të të erës tonë. Pjesë e kësaj zone është edhe zyra qendrore e Këshillit (ku u organizua takimi), që në të kaluarën ka qenë e shfrytëzuar si objekt banimi për shërbyesit e katedrales.



Fig. Katedralja e St. Canice's

Gjatë pjesë së pasdites në takim u diskutua për turizmin dhe aktivitetet që zhvillohen në ngritjen e ofertës turistike. Një prezantim për situatën në Kilkeni u realizua nga z. Colin Ahern, përgjegjës për turizmin në komunë sipas të cilit suksesi i turizmit është politika e promovimit të Kilkenit si komunë dhe jo i hoteleve dhe shërbyesve të tjerë veç e veç. Marketingu kryesisht është digjital, i cili në krahasim me format tjera është maksimalisht efikas dhe lehtë i matshëm. Aktualisht në funksion është projekti "Well come Ambassador", i cili kryesisht merret me ngritjen e kapaciteteve humane për pritjen e mysafirëve përmes punëtorive dhe formave të ndryshme. Në projekt janë të përfshirë edhe qytetarët duke ndikuar në përgatitjen e tyre për reagim në situata të ndryshme dhe dhënien e informatave të duhura. Aktualisht është duke u punuar në shtimin e nevojës për të realizuar më shumë bujtje në kapacitetet hoteliere. Raporti në mes mysafirëve vendor dhe të jashtëm është 75% me 25%, e shndërruar në bujtje mesatarja momentale është 1.2 bujtje për mysafir të brendshëm dhe 2.0 bujtje për mysafir të jashtëm.

Takimi në Këshillin Komunal të Kilkenit

Takimi u mbajt në ndërtesën e Këshillit komunal (shekulli XVII), nën udhëheqjen e nënkryetarit si nikoqir i takimit, i cili më shumë kompetencë foli dhe na ofrojë të dhëna të ndryshme për komunën dhe rregullimin e sajë. Sipas rregullimit aktual administrativ hapësinor, autoriteti i këshillit të rajonit të Kilkenit (90.000 banorë) ka ndikim vendimmarrës për çështjet dhe projektet shtetërore, për dallim nga këshilli komunal (25.000 banorë) që është përgjegjës për shërbimet, rregullimin hapësinor, infrastrukturën dhe projektet tjera me ndikim lokal. Pjesë e takimit ishin edhe përfaqësues të forcave mbrojtëse, që për rastësi në një periudhë kohore kishin qenë edhe pjesë e forcave të NATO-s në Kosovë.



Fig. Takimi në Këshillin komunal në Kilkeni

Në vazhdim të agjendës u realizuan disa vizita në terren që për qëllim kishin demonstrimin e trashëgimisë kulturore, zhvillimin lokal ekonomik, turizmin e trashëgimisë dhe angazhimin e komunitetit.

Vizita e parë u zhvillua në njërin nga monumentet më të mëdha dhe më mbresëlënëse të mesjetës në Irlandë (shek.XII) Kells Priory. Monumenti ndodhet në një fshat me bujqësi dhe blegtori shumë të zhvilluar, nëpër mes të të cilit kalon Lumi Kings. Momentalisht monumenti është në fazën e revitalizimit dhe restaurimit, një proces në të cilin janë përfshirë kompani profesionale dhe kompetente për këso lloj punësh.




Fig. Monumenti mesjetar Kells Priory

Vizita tjetër u realizua në njërin nga ndërmarrjet lokale (KNOCKDRINNA FARM SHOP) që merret me prodhimin e produkteve të qumështit. Furnizimin me qumësht të lopëve, dhenve dhe dhive që ushqehen vetëm nga natyra, e realizon nga fermerët dhe blegtorët e fshatit. Kompania u themelua me iniciativë familjare me përkrahje të fondeve për zhvillim të komunitetit dhe është në funksionon që prej dhjet viteve, është fituese e shumë çmimeve vendore dhe ndërkombëtare. Aktualisht është njëra nga pikat më atraktive të vizitave zyrtare (në vendin 19 në nivel shteti), sot një pjesë e konsiderueshme e prodhimeve eksportohet edhe në Mbretërinë e Bashkuar.



Fig. Pauza në ndërmarrjen e prodhimeve të qumështit



Fig. Ndërmarrja për përpunimin e qelqit

Në vazhdim të vizitave u njoftuam me ndërmarrjen lokale për përpunimin e qelqit (Jerpoint Glass Studio) që është një aktivitet tradicional i kësaj familje. I gjithë grupi u bëmë dëshmitar të një procesi prej fillimit e deri në fund të përpunimit me dorë të një vazoje unike qelqi.

Sipas agjendës të detajuar dhe të udhëhequr me shumë profesionalizëm dhe përpikëri nga Liam, vizita e radhës u organizua në qytetin mesjetar të ashtuquajtur "Qyteti i Humbur", të menaxhura nga një biznes familjar (Fermë e dhenve). Në kuadër të fermës, në bazë të hulumtimeve, para 800 viteve ka filluar ndërtimi i qytetit nga normanët. Shekuj me radhë ky qytet u zhvillua deri para 400 vetëve kur zhduket nga regjistrimet e kohës. Tregimet dhe shënimet i mbijetuan kohës deri para 150 viteve kur fillohet me vizatimet e para për vendin dhe formën e qytetit. Në fund të shek.XX historianët dhe arkeologët filluan të binden se diçka e rëndësishme fshihet në këtë zonë. Përfundimisht në vitin 2007 me angazhimin e Këshillit për Trashëgimi, duke i shfrytëzuar paisjet e sofistikuar për incizime nën tokë, u vërtetua dhe u dokumentua ekzistimi i qytetit. Sot, kjo zonë është njëra nga pikat e rëndësishme turistike, në të cilën përpos gjurmëve të qytetit ofrohen edhe shumë aktivitete tjera. Sipas pronarit i cili kryente edhe rolin e udhëheqësit turistik, njëri nga varret e prezantuara supozohet të jetë varri i Santa Claus-it (Baba Dimri).



Fig. Vizita në "Qytetin e Humber"

Ferma e mollëve organike (Highbank Organic Farm) ishte pika tjetër e vizitës tonë. Edhe kjo ndërmarrje është rezultat dhe iniciativë familjare dhe kontribuuesi rëndësishëm në marketingun e përgjithshëm të Kilkenit. Në fermën me sipërfaqe prej 20 Ha prodhohen disa varietete mollësh organike, që kryesisht shfrytëzohen për prodhime të ndryshme, nga të cilat uthulla dhe lëngjet ishin më të njohura, të gjitha me shenjë e prodhimit të licencuar organik². Puna e mirë që realizohet në këtë fermë është rezultat i funksionimit shumë të mirë të rrjetit të bashkëpunimit, pa të cilin është vështirë të mbijetohet. Moto e këtij rrjeti është "ushqimi i ngadalshëm" (slow food) që ka për qëllim shmangien nga ushqimet e shpejta (fast food) dhe të dëmshme për shëndetin.



Fig. Ferma e mollëve organike

Njëra ndër vizitat më atraktive u zhvillua në fabrikën e birrës "Smithwick's Brewery". Grupi ynë ishim njëri nga grupet e para që po e vizitonte fabrikën pas ndryshimeve rrënjësore në menaxhim dhe marketing. Më shumë se 3.5 milion euro ishin investuar për prezantimin e të gjithë historisë të vjetër më shumë se 300 vite. Rritja e cilësisë së birrës (për mua deri më tash më e mira) dhe investimet në marketing kanë ndikuar në rritjen e dukshme të prodhimit dhe shtimin e numrit të vizitorëve, nga të cilët përfiton i gjithë qyteti i Kilkenit.



Fig. Birra Smithwick's

² Në Irlandë 20% e prodhimeve ushqimore janë organike.

**Konkluzion:**

- Duke e parë situatën në Irlandë na bëhet edhe më e qartë se Trashëgimia Kulturore në Kosovë është në rrezik! Edhe përkundër punëve të mira që janë bërë, situata është ende e vështirë. Nuk mjaftojnë rregullat dhe ligjet e mira, duhet të rritet vetëdija dhe dashuria për trashëgiminë, e cila nuk duhet të jetë monopol i askujt, ajo duhet të jetë përgjegjësi e të gjithëve;
- Duhet të shtohen përpjekjet dhe të ofrohen mundësitë që trashëgimia të shndërrohet në burim të zhvillimit ekonomik. Trendi në rritje i turizmit të trashëgimisë kulturore dhe natyrore në botë, duhet të jetë motiv edhe për ne, për të gjitha strukturat që kanë ndikim. Planet Lokale për Trashëgiminë Kulturore duhet të jenë instrumentet me të cilat duhet të arrihet qëllimi i shfrytëzimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.
- Edukimi dhe ngritja e vetëdijes për trashëgiminë duhet të vazhdohet edhe më tutje dhe me më shumë energji. Ajo duhet të shtrihet në të gjitha struktura e shoqërisë dhe të përdoren të gjitha format e mundshme.
- Edhe përkundër vështirësive të mëdha që po kalon vendi, duhet të shtohen përpjekjet që të rritet buxheti për trashëgimi kulturore, ndonëse u konstatua se buxheti i lartë shpesh mund të jetë pengesë, në rastin tonë kjo është nevojë esenciale. U vërtetua se investimet në trashëgimi janë edhe potencial i fuqishëm i krijimit të vendeve të reja të punës.

Aktualisht ka shumë monumente që për shkak të mungesës financiare janë para shkatërrimit. Autoritetet përgjegjëse kanë vështirësi në ofrimin e ndihmës për pronarët e monumenteve, një pjesë e të cilëve të ndodhur në situatë të vështirë ekonomike në njërin anë dhe para presionit të ndërmarrësve nga ana tjetër, me lehtësi heqin dorë nga e kaluara historike e familjes.

- Gjatë vizitës, në takimet dhe diskutimet e organizuara u potencua se njëri ndër faktorët e rëndësishëm të zhvillimit të turizmit kulturor, është bashkëpunimi dhe ndihma reciproke e akterëve të përfshirë në këtë çështje. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim duhet ta kenë institucionet qendrore, të cilat në forma të ndryshme duke e përfshirë edhe atë financiare e promovojnë këtë faktor të rëndësishëm.

Luan Nushi, drejtor
Instituti për Planifikim Hapësinor
Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Prishtinë, 29.09.2014